

Tiranë, shtator 2024

STANDARDET E PËRFAQËSIMIT: PËRFSHIRJA E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ZGJEDHJE DHE NË JETËN POLITIKE

(Dokument pune)

Konteksti politik

Shqipëria do të zhvillojë zgjedhje parlamentare në pranverën e vitit 2025. Në funksion të tyre në korrik 2024 Kuvendi miratoi ndryshime të rëndësishme në formulën e aplikimit të sistemit zgjedhor, duke sanksionuar të drejtën e partive politike për të hartuar një listë të mbyllur kandidatësh në një të tretën e listës, vendim që de facto u jep të drejtën partive kryesore politike të emërojnë paraprakisht 100-105 mandate në parlamentin prej 140 deputetësh. Formula e re është një formë e ndërmjetme midis sistemit proporcional rajonal me lista të mbyllura aplikuar në zgjedhjet e vitit 2009, 2013, 2017 si dhe eksperimentit me lista pjesërisht të hapura përmes pragut të herësit (10000 vota) aplikuar në zgjedhjet e vitit 2021.

Në Regjistrin e partive politike në gjykatën e faktit Tiranë figurojnë 135 parti politike, të cilat, referuar të dhënave të KQZ të konfirmuara gjatë procesit të deklarimeve financiare vjetore¹, në mbi 70% të tyre janë parti të pidentifikueshme me adresë dhe funksionalitet. Një prej partive të regjistruara është edhe Partia “Personat me Aftësi të kufizuara”, e cila nga emërtimi përbën një parti me fokus qëndror PAK, por që *de facto* nuk ka arritur të sigurojë përfaqësim politik dhe për këtë shkak, as të avancojë problematikat e lidhura me kategorinë sociale që thekson. Një tentativë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2009, si kandidat i pavarur në Tiranë, Abdulla Omuri drejtues i

¹ KQZ. Raportet vjetore. <https://kqz.gov.al/document-category/raportet-per-kuvend/>

shoqatës së invalidëve, mori mbështetjen paraprake të 10 mijë qytetarëve, por në procesin final të votimit mori vetëm 756 vota².

Bazuar të dhënave të INSTAT në Shqipëri (2024) figurojnë 149 866 qytetarësh PAK, nga të cilët rreth 3 mijë janë nën moshën 18 vjec (moshë jo votuese), nga të cilët, mbi 99 mijë kanë probleme me ecjen, mbi 38 mijë me dëgjimin, mbi 52 mijë me shikimin. Megjithatë aktualisht nga më shumë se 140 deputetë, 16 ministra, 61 kryetarë bashkie dhe në tërësi, rreth 400 zyrtarë të lartë në nivel qendror dhe lokal, asnjë prej tyre nuk i përket PAK. Praktika e disa viteve më parë e emërimit të një zv/ministri nuk është përsëritur më, ndërkohë që partitë e mëdha politike, të cilat kanë potencial përfaqësimi dhe emërimi (PS, PD, PL, etj), kanë promovuar politika ose angazhime në mbrojtje të PAK, por jo përfaqësimin e tyre politik në listat e kandidatëve në zgjedhjet parlamentare ose lokale. Studimi më poshtë analizon edhe përfaqësimin në strukturat e partive politike, gjendjen, problematikat dhe rekomandimet konkrete përmirësuese.

Në studimet profesionale mbi sistemet zgjedhore dhe ato politike nuk rezulton një ndërvarësi midis sistemit dhe nivelit të përfaqësimit të PAK. Përfaqësimi është çështje e vullnetit politik dhe institucional, pjesëmarrja lidhet edhe me kushtet sociale dhe elementë teknikë administrativë, dhe vetë personat PAK (si në rastin e Shqipërisë) nuk janë ende një komunitet i organizuar që ka potencial të kushtëzojë votën dhe të detyrojë palët politike të sigurojnë përfaqësimin e tyre. Vota e tyre merret e mirëqenë në linjat e ndarjes ideologjike dhe mospjesëmarrja e tyre shoqërohet me rritje të neglizhencës dhe interesit të vetë partive politike, sipas parimit, abstenimi ose mospjesëmarrja është më e mirë sesa vota kundër.

Komisioneri Shtetëror për zgjedhjet në adresimin e tij zyrtar në Kuvend ka ngritur çështjen e pamundësisë aktuale për të votuar për një numër të madh qytetarësh të kategorisë PAK. Ai ka sugjeruar që partitë politike dhe Kuvendi, në kuadër të reformës të pritshme zgjedhore të gjejnë mënyrën që kjo kategori votuesish ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës. Nga ana tjetër, KQZ ka konfirmuar edhe shqetësimet lidhur me mjediset e votimit, të cilat në tërësinë e tyre janë të papërshtatshme për aksesin e votimit për personave me aftësi të kufizuara. Sipas tij institucioni ka bashkëpunim me koordinatoret e bashkive për këtë çështje dhe vetë KQZ po ndërton një bazë të dhënash në lidhje me gjendjen fizike të të gjitha qendrave të votimit në mënyrë që aty ku është e mundur të krijohet aksesin për këtë kategori votuesish. Deri në periudhën e shkrimit të këtij raporti ende asnjë bashki nuk ka deklaruar vullnet të plotë dhe masa konkrete për të mundësuar krijimin e infrastrukturës zgjedhore që krijon akses votimi për këtë kategori, si dhe ende nuk ka masa ligjore apo administrative për ndërhyrje përmirësuese në reformën zgjedhore apo në strukturën teknike të zhvillimit të procesit.

Fakti se Kuvendi tashmë ka sanksionuar të drejtën e votës përmes postës për diasporën (qytetarët që jetojnë jashtë vendit) e bën edhe më të lehtë të adresueshme nevojën që praktika të njëjta të aplikohen edhe për votën e asaj kategorie të PAK që nuk ka mundësi fizike të ushtrojë votën direkt

² KQZ. Vendim nr.602, date 01.08.2009 <https://cec.org.al/zgjedhjet-2009/>



në qendrat e votimit. Në zgjedhjet e vitit 1991, të cilat ishin të parat zgjedhje në Shqipëri në postkomuniste, pavarësisht saktësisë dhe standardeve zgjedhore në tërësi, u lejua dhe u mundësia votimi i lëvizshëm në spitale për të sëmurët, etj. Pas 34 vitesh Shqipëria mund ta aplikojë këtë përvojë modeste, por në formën dhe standardet e kërkuara bashkëkohore.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 mund të sigurohet ndryshimi pozitiv i treguesve nëse reforma zgjedhore e parashikuar të vijojë gjatë sesionit parlamentar të vjeshtës 2024, të marrë në konsideratë dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme dhe praktike për jetësimin e pjesëmarrjes reale të të gjithë votuesve PAK në zgjedhje.

Këto ndryshime duhet të vijnë edhe si rrjedhojë e njw baze aktuale aktesh dhe angazhimesh:

- *Ratifikimi i Konventën për të Drejtat e Personave me Nevoja të Veçanta në vitin 2012 të nënshkruar nga qeveria e kohës.*
- *Ligji 10221 për mbrojtjen nga Diskriminimi (2010).*
- *Strategjia Kombëtare për Punësimi dhe Aftësitë (2014-2020).*
- *Plani Kombëtar Veprimi për Personat me Nevoja të Veçanta 2016 – 2020.*
- *Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025.*
- *Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030).*

Reforma duhet të parashikojë edhe modifikime në sistemin e votimit (më shumë detaje ofrohen në vijim), si dhe reformimin e sistemit të financimeve elektorale, të hapësirës mediatike dhe të kushteteve për konkurrim, sidomos në rrethanat kur vota është zgjeruar edhe me atë të diasporës.

- *Sigurimi i kushteteve për pjesëmarrje, një detyrim dhe e drejtë kushtetuese, sjell edhe krijimin e mundësive për përfaqësimin e PAK direkt (me parti ose kandidatë) ose indirekt (përmes listave të partive ose koalicioneve të rëndësishme politike).*

A MUND TË REFEROHEN MODELET RAJONALE?

Problematikat zgjedhore janë të shumta dhe referimi në standardet e OSBE apo të Komisionit të Venecias nuk janë gjithnjë uniforme. Vende si Shqipëria, me deficite në treguesit e demokracisë funksionale, në burimet njerëzore dhe financiare, si dhe në standardet zgjedhore nuk mund të aplikojnë direkt standardet e larta të njëjta me vendet e BE, ndaj me qëllim progresin gradual drejt standardeve ekipi i ISP sugjeron referimin tek përvojat pozitive rajonale. Vende si Maqedonia e Veriut, Kosova apo Kroacia, Mali i Zi apo Serbia, mund të kenë përvoja pozitive, të cilat në periudhë afatshkurtër vlejnë edhe për Shqipërinë. Më poshtë janë përmbledhur disa praktikatat te sukseshme referuar vendeve si Kosova, Malit i Zi dhe Maqedonia e Veriut, tri vende me demokraci të brishtë dhe fqinje me Shqipërinë.

Përvoja dhe modeli i aplikuar në Kosovë

- Sipas legjislacionit zgjedhor në Kosovë konsiderohen persona me aftësi të kufizuar disa kategori të popullsisë me të drejtë vote, (personat me sëmundje apo aftësi të kufizuar për shkak të së cilës nuk mund të dalin nga shtëpia, personat në spitale, personat e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit, strehimoret për mbrojtjen e viktimave, personat që nuk mund të dalin nga shtëpia për shkaqe sigurie, si dhe personat në arrest shtëpiak). Për këto kategori ekzistojnë disa forma të regjistrimit paraprak për ushtrimin e të drejtës së votës.
- Votuesit me sëmundje apo aftësi të kufizuar për shkak të së cilës nuk mund të dalin nga shtëpia regjistrohen online ose në zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore, votuesit e disa kategorive (në institucione) regjistrohen gjithashtu online ose në institucionet respektive (KQZ në bashkëpunim me administratën e institucioneve bën evidentimin e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote në spitale, shtëpi të moshuarve dhe strehimoret për mbrojtjen e viktimave, si dhe për votuesit në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, në burgje dhe paraburgim). Në bazë të listës së krijuar, caktohen ekipet e lëvizshme, të cilat shkojnë në këto institucione për të organizuar procesin e votimit.
- Në këtë kategori përfshihen edhe tjetër votuesit që nuk mund të votojnë në qendër të votimit për shkaqe sigurie dhe votuesit që janë në arrest shtëpiak. Edhe këta regjistrohen online (ata që nuk mund të votojnë) ose nga KQZ në bashkëpunim me institucionet përkatëse (arrestit shtëpiak), si dhe ditën e votimit ekipet e lëvizshme dërgohen tek vendbanimet e këtyre votuesve dhe mundësojnë procesin e votimit³.

Përvoja dhe modeli i aplikuar në Maqedoninë e Veriut dhe në Malin e Zi

- Maqedonia e Veriut gjithashtu ka një legjislacion që mundëson pjesëmarrjen dhe votimin aktiv të personave me aftësi të kufizuar, atyre të sëmurë dhe atyre në kushte të vecanta. Në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe presidenciale (2024) KQZ njoftoi se *“personat e pafuqishëm ose të sëmurë votojnë në shtëpitë e tyre një ditë para datës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve”* duke ngarkuar Këshillin Zgjedhor për jetësimin e këtij vendimi. Sipas Kodit Zgjedhor në Maqedoninë e Veriut, neni 111/1, *“zgjedhësi i cili nuk është në gjendje të votojë në vendvotim (person i pafuqishëm apo i sëmurë) nëse dëshiron të votojë njofton KQZ-në ose KZZ-në përkatëse deri 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Njoftimi*

³ Për më shumë shih <https://kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-nevoja-te-vecanta/>.

bëhet direkt, online ose “nëpërmjet personit të autorizuar”⁴. Votimi në këtë rast bëhet në shtëpinë e personit, një ditë para se të mbahen zgjedhjet në nivel kombëtar, duke përdorur kuti të veçantë votimi.

- E njëjta praktikë aplikohet edhe votuesit në institucionet për përkuqdesje jashtëfamiljare (neni 111-a). Edhe zgjedhësit me nevoja të veçanta (neni 112/a) përfshihen aktivisht në votim. Personat në paraburgim shtëpiak votojnë tre ditë para ditës së zgjedhjeve, për kategori të tjera një ditë para ditës së caktuar për votim. Legjislacioni përcakton procedurat dhe afatet administrative për secilin rast dhe secilën kategori. Mbi këtë bazë “personat e pafuqishëm ose të sëmurë votojnë në shtëpitë e tyre një ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve” dhe se ofrohet zgjidhje për të gjitha kategoritë e tjera, përfshirë ata që janë të akomoduar në institucione të posaçme për kujdes jashtë familjar, etj.
- Edhe në rastin e Malit të Zi për personat PAK aplikohet votimi paraprak me postë, si dhe njësoj si në rastin e Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut, ka procedura të detajuara lidhur me mënyrën e përgatitjes dhe realizimit të këtij votimi.

DISA PRAKTIKA TË MIRA NGA ZGJEDHJET NË DISA VENDE EUROPIANE 2024

AUSTRIA

Në Austri, çdo komunë dhe çdo distrikt i Vjenës duhet të ketë të paktën një qendër votimi që është e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

BELGJIKE

Votuesit belgë me aftësi të kufizuara mund të përdorin një votim të përshtatur posaçërisht kabina e vendosur aty ku mund të kenë akses. Kabina mund edhe të jetë vendosur jashtë qendrës së votimit.

BULGARIA

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Bullgar vë në dispozicion një video në faqen e saj të internetit që përshkruan procedurat e votimit për personat me aftësi të kufizuara. Ai përfshin përkthimin e gjuhës së shenjave.

KROACI

Votuesit në Kroaci mund të marrin një certifikatë që i lejon ata të votojnë në çdo qendër votimi. Kjo u mundëson personave me aftësi të kufizuara të identifikohen qendrat e votimit ku ofrohet ndihma.

QIPRO

⁴ Për më shumë shih Kodi Zgjedhor në RMV <https://www.sec.mk/sq/regulativa/#izboren-zakonik>

Qiproja ka vendosur që madhësia maksimale e fletës së votimit duhet të jetë 16x70 cm për ta bërë më të lehtë plotësimin e fletës së votimit.

REPUBLIKA ÇEKE

Në Republikën Çeke përgatitet një fletëpalosje me informacion të përgjithshëm në forma të ndryshme, të përshtatura për nevojat e personave me lloje të ndryshme të paftësisë.

DANIMARKË

Në Danimarkë, një hapësirë e gjerë për votim të hershëm i lejon të gjithë personave që ta bëjnë këtë votoni nga dy ditë deri në tre javë përpara në votim të caktuar stacionet. Opsioni për të votuar herët është veçanërisht i dobishëm për personat me aftësi të kufizuara, të cilët shpesh kërkojnë të bëjnë rregullime për votim përpara.

ESTONIA

Të gjithë qytetarët në Estoni mund të votojnë në mënyrë elektronike.

FINLANDA

Ministria e Drejtësisë në Finlandë paguan për një informacion zgjedhor fletëpalosje që do të botohet në Braille.

FRANCE

Franca është një nga disa vende që lejon jovotuesit si p.sh fëmijët për të ndihmuar të rriturit me aftësi të kufizuara për të votuar.

GJERMANI

Personat e verbër në Gjermani mund të porosisin shabllone të fletëve të votimit shoqëruar nga një CD që përfshin udhëzimet për përdorimin e shabllon dhe informacion zyrtar për zgjedhjet në Braille.

GREQI

Në Greqi votimi është i detyrueshëm për të gjithë qytetarët. Megjithatë, që nga votimi i detyrueshëm është shpesh stresues për personat me aftësi të kufizuara, Autoritetet greke janë shumë fleksibël kur zbatojnë rregullin.

HUNGARIA

Një person me aftësi të kufizuara në Hungari mund të tregojë nevojën e tij/saj një qendër votimi të aksesueshme deri në dy ditë para zgjedhjeve.

IRLANDA

Votuesit që jetojnë në institucionet e kujdesit afatgjatë në Irlandë mund të aplikojnë për të përfshihen në një listë të veçantë zgjedhësish. Nëse aplikimi është i suksesshëm, oficerët e posaçëm që kthehen vizitojnë aplikantët individualisht për t'i regjistruar vota.

ITALI

Në Itali, autoritetet lokale ofrojnë transport në qendrat e përshtatshme të votimit për ata me lëvizshmëri të kufizuar.

LETONI

Votuesit në Letoni, si në dhjetë vende të tjera të BE-së, nuk mund të privohen të drejtën e tyre për të votuar në çdo rrethanë.



LITUANIA

Në Lituanë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron një online hartë që identifikon qendrat e votimit më të përshtatshme për votuesit lëvizshmëri e reduktuar.

LUKSEMBURG

Në Luksemburg, një votues mund të caktojë edhe një anëtar të zgjedhjeve komision si asistent i saj ose i tij.

MALTA

Në Maltë çdo qendër votimi duhet të jetë e pajisur me audio player dhe një model Braille që liston kandidatët dhe partitë në letër bale.

HOLANDË

Votuesit në Holandë mund të përdorin një xham zmadhues të dhënë çdo qendër votimi.

POLONIA

Në Poloni "Qendrat e Mbyllura të Votimit" organizohen në spitale dhe institucionet e kujdesit afatgjatë që kanë të paktën 15 persona që qëndrojnë atje.

PORTUGALI

Një votë në Portugali numërohet nëse tregon qartë vullnetin e votuesit, edhe pse shenja e tij ose e saj në fletëvotim mund të bjerë jashtë kutisë.

RUMANI

Rumania i lejon votuesit të bëjnë një shenjë pranë emrit të një kandidati duke përdorur një vulë të marrë nga komisioni zgjedhor.

SLLOVAKIA

Në Sllovaki, ata që ofrojnë kujdes të përhershëm për votuesit me personat me aftësi të kufizuara mund të votojnë njëkohësisht në të njëjtën kuti të lëvizshme.

SLLOVENI

Përpara çdo zgjedhjeje, ministrinë përkatëse në Slloveni i dërgojnë njoftime spitale dhe institucionet e kujdesit afatgjatë që listojnë sa banorë ose pacientët mund të ushtrojnë të drejtën e tyre të votës.

SPANJË

Në Spanjë, një person me aftësi të kufizuara që nuk mund të shkojë në zyrën postare për të kërkuar votën me postë mund të thërrasë një noter publik. Ai zyrtar do, pa pagesë, jepni prokurë personit të caktuar nga zgjedhësi të plotësojë kërkesat e votimit me postë.

SUEDI

Një votues që ka marrë një fletë votimi për një votim me postë në Suedi mund të ndryshojë mendje dhe t'ua dorëzojë fletën e votimit personalisht qendra e votimit në ditën e zgjedhjeve.



REKOMANDIME PRIORITARE PËR 2025

- I. Kuvendi duhet të përfshijë në prioritetet e reformës zgjedhore një proces real për të siguruar të drejtat e plota zgjedhore të PAK.
- II. Qeveria qendrore përmes Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe KQZ duhet të sigurojnë mjedise të përshtatshme votimi për të gjitha kategoritë e PAK.
- III. Pamundësimi në çdo formë i votës së PAK në zgjedhje të konsiderohet pjesë e krimeve zgjedhore dhe zyrtarët përgjegjës të përballen me pasojat ligjore.
- IV. Partive dhe kandidatëve që vijnë nga PAK tu krijohen mundësi kandidimi në të gjitha nivelet e përfaqësimit zgjedhor dhe politik
- V. Komisioneri kundër Diskriminimit, Avokati i Popullit dhe KQZ mund të nxisin partitë të deklarojnë në programe elektorale platforma të dedikuara lidhur me PAK
- VI. Të gjitha mbledhjet dhe vendimmarrjet, përfshirë mbledhjet e qeverisë dhe të parlamentit, duhet të shoqërohen me interpretimin e gjuhës së shenjave
- VII. KQZ mund të jetë më aktiv në informimin dhe sensibilizimin e PAK për të drejtat zgjedhore përmes materialeve edukative dhe fushata në formate të aksesueshme.
- VIII. Faqja zyrtare e KQZ duhet të ofrojë informacion dhe akses edhe për votuesit PAK që nuk shikojnë ose dëgjojnë.

Transporti është një tjetër pengesë. Shumë forma të transportit publik nuk janë projektuar duke pasur në konsideratë specifikat e komunitetit me aftësi të kufizuar . Po ashtu, aksesit ndryshon shumë në varësi të vendndodhjes; zonat rurale ose periferike kanë më pak të ngjarë të kenë mundësi aksesit në transportin publik sesa zonat urbane.

Kjo forcë politike përdor më shumë mediat sociale për të komunikuar dhe informuar PAK mbi veprimtarinë e PPAK-së. Megjithatë, “buxheti i kufizuar krijon pak mundësi për të aplikuar programin Braille dhe për të pasur një përkthyes në çdo aktivitet që organizohet apo video që postohen.”

Një problem tjetër lidhet me aspektin e votimit. Në shumë qendra votimi, ato nuk zhvillohen në katet e para, duke e bërë të vështirë dhe të pamundur për disa kategori të personave me aftësi të kufizuar ushtrimin e të drejtës së votës. Pavarësisht se ligji zgjedhor e ka të përcaktuara qartë detyrimin për përmbushjen e kushteve që personat me aftësi të kufizuar të ushtrojnë të drejtat e tyre kushtetuese, nuk mungojnë rastet që këto të drejta nuk ushtrohen për shkak të mungesës së kushteve. Personat me dëmtime fizike nuk arrijnë të lëvizin me automjete lëvizëse në zgjedhjet jo vetëm për shkak të mungesës së rampës në katet e para, por edhe pse disa qendra votimi vendosen në katet e larta në ndërtesa pa ashensorë.



PRIORITETET AFATSHKURTRA DHE AFATGJATA PËR REFORMIMIN E PARTIVE POLITIKE DHE NDËRHYRJET NË SISTEMIN ZGJEDHOR

Rekomandime për partitë politike lidhur me formulimin e politikave ndaj PAK (në programe)

- I. Neni 4 i KDPAK cilëson që partitë politike duhet të marrin mendime nga personat me aftësi të kufizuar për çështje që shqetësojnë komunitetin në fjalë. Specifikat e çështjeve që lidhen me këtë komunitet nuk janë të ngjashme me ato që shqetësojnë grupet të tjera sociale.
- II. Siç rekomandohet me të drejtë nga OSBE / ODIHR stafi që punon për një parti politike ka nevojë të trajnohet për të kuptuar më mire specifikat e çështjeve që lidhen me këtë komunitet. Trajnimet mund të ndihmojnë stafin të punojë më mirë me personat me nevoja të veçanta. Trajnimi mund të ndihmojë personelin të kuptojë se si të bëjë modifikime të pranueshme për personat me nevoja të veçanta.
- III. Partitë politike duhet të ndërtojnë sistemin e mentorimit që të mund të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuar të jenë aktiv në jetën politike dhe të përfshihen në konsultat që organizohen në ndërtimin e programeve politike në periudha parafushatave zgjedhore.
- IV. Partitë politike duhet të përfshijnë në komisionet për hartimin e programeve social - ekonomike edhe përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuar.
- V. Rishikimi i statuteve dhe rregulloreve të brendshme të partive për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar të përfshihen në strukturat drejtuese dhe administrative të partisë dhe në proceset vendimmarrëse. Partitë politike të sigurohen që personat me aftësi të kufizuar të inkurajohen të angazhohen aktivisht në administratën partiake dhe në aktivitete të tilla si zhvillimi i politikave, fushatave dhe shpërndarjen e materialeve të fushatës.
- VI. Partitë politike duhet të nxjerrin mësim nga përdorimi i kuotave gjinore dhe nga kuotat e përcaktuar për personat me aftësi të kufizuar nga rajone të tjera. Përcaktimi i kuotave për PAK do të shërbejë si hap drejt realizimit të pjesëmarrjes politike të PAK. Kuotat duhet të kenë mbështetje nga shumë palë të interesuara. Kjo përfshin parti të ndryshme politike, shoqata që mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar nevoja të veçanta të cilët duhet të bien dakord për rregullat dhe qëllimin e kuotave.
- VII. Kuotat mund të jenë më efektive nëse kombinohen me edukimin qytetar. Kuotat nuk kanë të bëjnë me zgjedhjen e personave me aftësi të kufizuar vetëm e vetëm se ata kanë nevoja. Përkundrazi, kuotat janë një mundësi për kandidatët e kualifikuar me aftësi të kufizuara të kenë një mundësi të barabartë për të kandiduar për poste drejtuese dhe përfaqësuese si gjithë të tjerët. Ekspertët për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar sugjerojnë se

çiftëzimi i një kuote me programet e edukimit qytetar mund të jetë një kombinim më i fortë sesa vetëm vendosja e kuotave.

- VIII. Departamenti i partive politike që merret me regjistrimin e anëtarësisë duhet të zhvillojë një bazë të dhënash për anëtarët me aftësi të kufizuara . Të promovojnë praktika demokratike në partitë e tyre për të akomoduar PAK.
- IX. Partitë politike të mundësojnë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në listën shumë emërore për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore. Partitë që janë më gjithëpërfshirëse do të kenë më shumë gjasa të tërheqin më shumë vota. Personat me aftësi të kufizuara ofrojnë perspektiva unike që aktualisht u mungojnë partive politike shqiptare. Eksperienca e suksesshme e vendeve të tjera e tregon këtë gjë.
- X. Partitë politike duhet të shpërndajnë platforma në formate të aksesueshme dhe të organizojnë takime, fjalime, njoftime dhe debate në vende të aksesueshme, duke përfshirë përkthyes të gjuhës së shenjave. Kjo do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë akses të barabartë në informacion dhe të jenë të informuar për të qenë në gjendje të bëjnë zgjedhje e duhur për të dhënë votën e tyre. Informacioni i shpërndarë nga partitë politike duhet të jetë në formatin audio dhe vizuale.
- XI. Partitë politike duhet të zhvillojnë edukimin e votuesve duke synuar personat me aftësi të kufizuara në mesazhet që përcjellin për publikun e gjerë. Kjo qasje do të mundësojë që informacioni të jetë i aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara si dhe do të përfshijë konceptin e personave me aftësi të kufizuara si pjesë e elektoratit dhe kandidatëve, duke ndihmuar kështu në zbutjen e paragjykimëve stereotipeve dhe etiketimeve që adresohen shpesh ndaj këtij komuniteti.
- XII. Organizatorët e aktiviteteve politike duhet të marrin në konsideratë vendndodhjen ku do të zhvillohen Town Halls, fjalimet dhe bashkëbisedimet me qytetarët. Në disa raste, për të organizuar bashkëbisedimet, partitë politike mund të kenë nevojë të punojnë së ngushtë me PAK për të zgjedhur një vend të përshtatshëm.

Në funksion të një strategjie konkrete veprimi, bazuar edhe në praktikatat e mira të vendeve tashmë anëtare në BE, po ju paraqesim në vijim **disa kritere** teknike që duhen të mbahen parasysh kur organizohet një aktivitet i tillë:

- Vendi duhet të jetë jo më shumë se 5-minuta në këmbë nga transporti publik.
- Hyrja duhet të ketë një rampë me parrmakë ose mund të jetë në nivelin e tokës.
- Vendi ku do të mbahet Town Halls, fjalimi ose debati duhet të mbahen në katin e parë, ose në kate më lartë por me kushtin që të ketë një ashensor që mund të zë një karrige me rrota ose skuter..
- Nevojitet një zonë qëndrimi i rezervuar për personat që përdorin pajisje lëvizëse dhe që kanë pamje të pranueshme për të ndjekur aktivitetin.
- Përdorimi i një gjuhe të qartë dhe të thjeshtë në të gjitha faqet e internetit.
- Vendosja e titujve dhe nëntitujve në faqet e internetit dhe artikujt.
- Përzgjedhja e ngjyrave me kontrast të lartë.
- Shmangia e përdorimit të ngjyrave si treguesin e vetëm të informacionit të rëndësishëm.
- Shmangia e përdorimit të termave të tillë si "kliko këtu" ose "më shumë" si tituj lidhjesh.
- Përfshirja e tekstit alternativ ("alt-tekst") për ilustrime, grafikët dhe fotografitë.
- Vendosja e titrave në video.
- Shtimi i materialeve audio në video.
- Përfshirja e transkripteve për regjistrimet audio si spotet radiofonike ose podcastet.

Burime kryesore të përdorura

1. *World Report on Disability*” World Health Organization, (2011).
<https://www.who.int/teams/noncommunicable-diseases/disabilityand-rehabilitation/world-report-on-disability>
2. *Population and Housing Census, 2011*, <http://www.instat.gov.al/en/themes/censuses/census-of-population-and-housing/>
3. *Population and Housing Census, 2023* <https://www.instat.gov.al/en/census-2023/>
4. *Albanian Disability Rights Foundation (2012) Electoral rights for votes with disabilities, Page 11.*
https://eaccess.s3.amazonaws.com/media/attachments/resources_mainresource/439/Electoral%20Rights%20for%20Albanian%20Voters%20with%20Disabilities.pdf
5. *Monitoring the national disability action plan (2016- 2020) Summary (2019)*<file:///C:/Users/Administrator/Downloads/PAK-eng.pdf>
6. *OSCE/ODHIR (2017) Udhëzues për vëzhgimin dhe promovimin e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuar në zgjedhje, Page 25.*
<https://www.osce.org/files/f/documents/2/9/418820.pdf>
7. *Statuti i Partise Demokratike (2023)* <https://pd.al/statuti/>
8. *Statuti i Partise Socialiste (2018)* <https://pd.al/statuti/>
9. *Parliamentary Assembly (2017) The political rights of persons with disabilities: a democratic issue.* <https://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=23519&lang=en>

